



# FONDACIONI SHQIPTAR I BURSIVE

*Mbështetja e arsimit të lartë të Shqiptarëve të talentuar në Maqedoni*

Bul. Stiv Naumov 22/1-4, 1000 Shkup, Maqedoni

faks +389-2-323-9897

[kontakt@fshb.org](mailto:kontakt@fshb.org)

## PROGRAMI I FONDACIONIT SHQIPTAR TË BURSIVE

Duke marrë parasysh faktin se shkollimi i lartë përfaqëson një fushë me interes të lartë kombëtar për zhvillimin e gjithmbarshëm të një shteti si dhe të rajonit në përgjithësi, grupi i qytetarëve në bledhjen e saj të mbajtur në Janar të 2004 sollën vendim për themelimin e Fondacionit Shqiptar të Bursave.

### **Qëllimet programore të Fondacionit janë:**

1. Fondacioni do të punojë në rritjen e vetëdijes së popullatës se me ngritjen e shkallës së arsimit të shqiptarëve në Maqedoni do të përfitojnë jo vetëm shqiptarët por edhe qytetarët tjerë në vend.

Me ngritjen e shkallës së arsimit të shqiptarëve Republika e Maqedonisë do të zhvillohet shumë më shpejtë gjë që do të mundësojë edhe ndryshim thelbësor të gjendjes materiale dhe financiare të qytetarëve të saj. Përveç kësaj, me qytetarë të arsimuar mirë Republika e Maqedonisë do të mund të kyqet në të gjitha rrjedhat e arsimit të lartë dhe të shkencës që sot praktikohet në botën e zhvilluar e që njëkohësisht është edhe obligim që rrjedh me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës.

2. Fondacioni do të ndan bursa për arsim të lartë vetëm kandidatëve të Republikës së Maqedonisë. Bursat do të ndahen për të gjitha sferat studijuese por me prioritet të veçantë për lami të deficitare. Gjithashtu, me bursa do të përfshihen të gjitha nivelet e shkollimit të lartë, studimet universitare, studimet pasuniversitare si dhe ato të doktoraturës dhe pasdoktoraturës.
3. Fondacioni do të siguron fonde nga popullata, nga institucione dhe nga persona në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj në mënyra dhe forma të cilat do të caktohen nga organet e fondacionit.
4. Që të punojë me sukses, Fondacioni do të formojë organe dhe trupa nga persona shkencorë dhe ekspertë nga lami të ndryshme të cilët do të ndihmojnë me punën e tyre.
5. Fondacioni, përmjet mjeteve të shtypura dhe elektronike të informimit, sëpaku njëherë në vit do të raportojë për punën e saj.